Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	**12.10.2023**	**26.10.2023**	**2023/0762**
Eksperti Teknik **Enver Bytyçi**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **16.10.2023**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 05.10.2023, OE "Astraplan SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0762, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Astraplan SH.P.K."- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË" me nr. të prokurimit: "214-22-10936-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 1 538 842,70 €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 356-373-389/2023 i dt:01.08.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Neni 105 i LPP-së - Kompetencat e OSHP-së
Neni 6 i LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve RRUOPP, paragrafi 40.3
Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 i LPP-së - Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 69 i LPP-së -Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale b
Neni 9.1 & 9.2 te DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Neni 105 i LPP-së - Kompetencat e OSHP-së - Drejtori i zyrës se prokurimit pran AK-s, ka shkelur këtë nen dhe ka vepruar ne kundërshtim me vendimin e OSHP-s me nr**. PSH. Nr. 373/2023**, me çka OSHP-ja do te duhej ne ditët ne vazhdim ti revokoj Certifikatën e prokurimit Artan Fejzes.
OSHP-ja ka vërtetuar ne vendim se neve jemi eliminuar kundërligjshëm dhe për kundër kësaj ZPP-Artan Fejza na eliminon përsëri.

Neni 6 i LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelej te nenit 6 pasi nuk është kujdesur qe ne përputhje me neni 6 piken 1 dhe 2 te këtij neni ku të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, dhe na ka diskualifikuar edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kushtet e kërkuara ne njoftim për kontrate dhe ne dosje te tenderit. Arsyet e eliminimit nuk qëndrojnë dhe nuk janë te mbështetura ne LPP-e, si dhe ka rekomanduar për kontrate një kompani me çmim me te larte se oferta e jone, saktësisht për **47,680.59 €.**

Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

AK-ja ka bere diskriminimin e kompanisë tone pasi qe i kemi plotësuar te gjitha kërkesat ne Dosjen e Tenderit dhe ne Njoftimin për Kontrate dhe kemi çmimin me te lire si OE me renditjen nr. 1 i përgjegjshëm. AK-ja ka qen e obliguar qe te analizoj kërkesën ne Neni 9.1 & 9.2 te DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne DT dhe ne njoftim për kontratë, pasi qe ne rastin konkret te gjitha i kemi plotësuar.

- **Arsyetimi i Artan Fejza është për keqardhje, po ashtu kamuflimi dhe manipulimi me dëshmitë e tenderit dhe dokumente te tenderit për përfitime personale tuajat**

dhe për inatet personale qe i ke me kompaninë tone, kjo është vepër penale nga ana e juaj.

- **Ka keqpërdorur 47,680.59 €. te buxhetit te Republikës se Kosovës dhe keni vonuar Policinë e Kosovës ne realizmin e projektit për me shume se 270 dite vonesë (30 ditë max. do duhej te kryhej vlerësimi), qe nga dita e dorëzimit te tenderit kanë kaluar 9 muaj, 3 jave e 6 ditë (300 dite deri me sot)**

JU informojmë se :

1. Nëse AK-ja kërkon Kamion me kran, posedojmë 1 cope deri 27 tone bartje dhe 8.125 ton ngarkim shkarkim me kran, si dhe 1 cope deri ne 5.21 ton
2. Nëse kërkon Autovinç posedojmë + 2 copë (24 ton + 29.1 ton)

Ne vazhdim ne detaje do te ju sqarojmë edhe njëherë për shkeljet qe i keni bere ne këtë aktivitet te prokurimit



Pesha bartese deri ne 27 tone rimorkio

Koka tërheqëse është për me tërheq rimorkion, peshën e barte rimorkio, për interpretim te rrejshëm dhe te qëllimshëm për te na eliminuar ju Artan Fejza, do duhej te shkonit ne përgjegjësi sepse nuk është hera e pare qe neve si Astraplan shpk na keni dëmtuar.

Te merret guximi dhe te thuhet se "SHLEPERI" nuk ka mundësi te barte 7 ton, duhet te merren organet e rendit me ZPP-n, për shkeljet flagrante qe eshte duke i bere dhe duke e bllokuar këtë projekt për afro 1 vit, dhe jo vetëm ketë por edhe tjera projekte, për shkak te inateve personale tijat me neve si OE dhe disa te tjerë qe nuk po te ofrojmë mundësin me përfitua personalisht.

Ne dokumentin e dorëzuar me oferte ne platformën e e-prokurimit:

- ***(dokumenti me nr. 6.4 LISTA E PAISJEVE UNIVERSAL DHE UNICRON SHPK PJESA 3),***
- faqe 5: Foto e kamionit me rimorkio Koka tërheqëse me targa 03-524-DE dhe rimorkio me targa 03-436-XB.
- Faqe 6: Libreza (CRA) me nr. 1923154, targat **03-524-DE, Koke tërheqëse me kran**, **F1**-pesha bartëse **7200 kg** ose (**7.2 ton**)
- Faqe 7: Libreza (CRA) me nr. 1542907, targa **03-436-XB**, **Rimorkio**, **F1**-pesha bartëse **24900 kg,** (**24.9 ton**)
- **Rimorkio me koke tërheqëse është kamion i kompletuar, dhe kan kapacitet se bashku 7.2 pesha bartëse e aksit te kokës tërheqëse, 8.125 ton vinçi dhe 24.9 ton mund te barte transport te materialeve.**

6/15

unicron
420

- Faqe 8: Libreza (CRA) me nr. 1536733, targa **03-390-DI, Autovinç, F1**-pesha bartëse **24000 kg** ose (**24 ton**)

- Faqe 10: DUD CS-0101 me nr. IE0310919D, Makine transporti për qëllime speciale **Vinç, F1**-pesha **29100 kg** ose (**29.1 ton**)

❖ **Nga sa ju sqaruam me larte kërkesën e kemi plotësuar dhe tejkaluar disa here,**

Pra, jemi ne Astraplan shpk me çmimin me te lire dhe i plotësojmë te gjitha kërkesat te DT dhe njoftim për kontrate.

Ne kërkesë për ri-shqyrtim ju kemi bashkëngjitë dëshmi dhe specifika për kamion te ngjashëm te cilat mund ti vërtetoni edhe vet ne internet.

Nëse krahasoni citimin tuaj ne arsyen e anulimit ne ju kujtojmë se veturat personale peshën bartëse e kanë maksimum për 5-7 persona ne varësi te veture, ne bagazh maksimum 500 kg, ndërsa këto automjete shpesh here bartin kamp shtëpizat me peshe deri 2000-3000 kg, ose edhe rimorkio me peshe bartëse deri ne 3000 kg, valle mos edhe kjo na qenka ne "kundërshtim" me rregullat e komunikacionit???????!!!!!!!!!!!!!



Shembulli 3.

Shembulli 4.

Shembulli 5.

Shembulli 6.

Ne foto mostra si me larte ju dëshmuam se ju nuk keni njohuri për qa flisni, keni kaluar kompetencat tuaja dhe jeni duke u marr me rregulla komunikacioni qe përveç qe nuk keni njohuri për to, edhe e keni te ndaluara rreptësishtë për vlerësim tenderit te merreni me jashtë

asaj qe kërkohen te dosje te tenderit dhe njoftim për kontrate, Fejza nuk e njih as LPP-n ose ma mire me thënë nuk doni ta njoh dhe zbatoni dhe atë gjithnjë ka vlerësuar sipas preferencave te tijat jo sipas LPP-s.

Diskriminimi i Astraplan shpk ne raport me OE te rekomanduar për kontratë PRO & CO Group shpk.

Diskriminimi nr. 1. Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, AK_ja ne kundërshtim me këtë nen nuk ka kërkuar para rekomandimit për kontratë, nga qasja ne dokumente nuk na janë prezantuar dokumentet e me poshtme.

b) Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës

c) Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike- Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë" së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës,

d) Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

Diskriminimi nr. 2. Lista e Kontratave

Kerkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 1,000,000.00 €

OE I rekomanduar për kontratë ne listën e kontratave te ngjashme qe ka paraqitur ne dosjen e tenderit duhet te merren parasysh vetëm kontratat nga data 13.10.2022 deri me 13.10.2019.

Kontrata e paraqitura ne liste e qe plotësojnë kushtin e mësipërm, arrijnë vlerën

Lista e kontratave te ngjashme e OE te rekomanduar per kontrate PRO & CO Group Shpk me aktivitetin e ankeses		
Nr. I renditjes ne liste	Vlera e references	Sqarime
6	260,927.28	ne rregull
7	271,690.55	ne rregull
10	39,891.70	ne rregull
11	14,632.00	ne rregull
12	41,953.00	ne rregull
Totali:	**629,094.53**	ne rregull
14	459,990.26	**Data e nënshkrimit me 27.04.2020 nga grupi i OE Pro & Co Group shpk & ARCHI TIME SHPK dhe N.N.T. " A.B.C. " me kohëzgjatje**

		prej 36 muajsh, dmth ne kohen kur është dorëzuar oferta qe është ne proces te ankesës, 1. Kjo kontrate ka qen e pa përfunduar dhe nuk munde te merret për baze ne këtë vlerësim. 2. Titulli I kontrates është Mirëmbajtja e objekteve te administratës komunale ne Prizren 3. Mungon Referenca, edhe pse ka një reference me tjetër titull qe po përputhet numri brendshëm i prokurimit, kjo është ne kundërshtim me kërkesën e DT-s dhe NJK	
15	322,281.50	Kontrata është nënshkruar me 03.08.2022 me kohëzgjatje prej 36 muajsh, dmth ne kohen kur është dorëzuar oferta qe është ne proces te ankesës kjo kontrate ka qen e pa përfunduar dhe nuk munde te merret për baze ne këtë vlerësim. Referenca e paraqitur për këtë kontrate është e pa vlefshme sepse, ne ketë reference edhe AK-ja e ka shënuar qe punimet janë e kryer pjesërisht, e qe është ne kundërshtim me kërkesën e DT-s dhe NJK	
Totali:	**782,271.76**		

Dmth OE i rekomanduar për kontrate nuk e plotëson kushtin e kërkuar prej 1,000,000.00 €, për pune te ngjashme dhe është i pa përgjegjshëm.

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve RRUOPP, paragrafi 40.3

AK-ja ka bere shkelej te afateve kohore pasi qe vlerësimi fillestar ka zgjatur nga dita e hapjes me 29.11.2022 deri me 16.02.2023 vendimi i pare (79 ditë)
ri vlersimi nga data 27.02.2023 deri me 23.05.2023 (85 ditë)
Qe nga data e dorezimit te ofertave deri me 05.10.2023 kan kaluar 10 muaj e 6 dite (310 dite ne total) kjo nuk don koment.

Citojme paragrafin 40.3- ***Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.***

Nga te gjitha te cekurat me larte, konstatojmë se komisioni vlerësues dhe ZPP-ja ka vepruar ne kundërshtim me LPP-s dhe na ka eliminuar për kundër se i kemi plotësuar te gjitha kushtet e kërkuara ne njoftim për kontrate dhe ne dosje te tenderit.
Arsyet e eliminimit nuk qëndrojnë dhe janë ne kundërshtim te plote me LPP-e dhe RRUOPP.

Kërkojmë nga OSHP qe konform Nenit 25, paragrafi 8 dhe rregullores nr. 2/2017-**PËR PROCEDURAT E REVOKIMIT TË CERTIFIKATËS PROFESIONALE PËR PROKURIMIN PUBLIK,** ***te merr masa ndaj zyrtarit kryesore te prokurimit.***

Pas përshkrimit të fakteve të lartshënuara dhe gjendjes faktike, *pasi qe e plotësojmë kushtin tenderi i përgjegjshëm me çmimin më te ulët.* nga paneli shqyrtues në OSHP kërkojmë që te merret:

VENDIM

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik ASTRAPLAN SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit: NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË, me nr. Prokurimit 214-22-10936-5-1-1.

II. Kjo ankese TRAJTORHET SI QESHTJE E GJYKUAR "RES-JUDICATA", pasi qe aktiviteti i prokurimit, palët dhe pretendimet janë te njëjta sikurse ne ankesën me nr. PSH. Nr. 373/23,

III. Anulohet njoftimi mbi Vendimin e AK-s Policia e Kosovës për dhënie te kontrates, si dhe aktiviteti i Prokurimit: NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË, me nr. Prokurimit 214-22-10936-5-1-1, kthehet ne RI-VLERESIM

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat tek Kapaciteti teknik dhe profesional:9.1 & 9.2 (kërkesa 1dhe 5).

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kerkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 1,000,000.00 €	**Deshmi 1-Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të nënshkruar dhe realizuara të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate), të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, të dëshmuara me referenca ose raporte përfundimtare të pranimit teknik në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatëse, për punët e realizuara dhe pranuar , te cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, natyrën e punës dhe vendin e realizimit të punëve. • Kur ndërtimi i është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër (jashtë RKS), për dëshmi duhet te dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera) te lëshuara nga autoriteti i tillë. • Kur ndërtimi është bere për një blerës privat, duhet te dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e punëve ose raportet e pranimeve teknike përfundimtar**
Kerkes 5-OE duhet ta ofrojë listën mbi mjetet e punës e nënshkruar dhe vlerësuar nga OE me pajisjet ne vijim Pesë (5) kamion veteshkarkues minimum 10m3-15m3, • Dy (2) eskavator me minimum 8ton, • Nje(1) cilinder min 10ton, vibrues • Nje autovinç (kamion per bartje te materialeve ndertimore min 7ton) • Një (1) vinç statik qe vendoset ne vende punishte me lartësi deri ne 30m, •Pajisje skele, dërrasa min 1000m2 (sipas udhëzimit te fundit kërkohet qe te përcillet objekti me skele gjate ndërtimit për shkak te sigurisë ne punë i gjithë perimetri i objektit). • Një (1) gjenerator me kapacitet min. 20-35 KWA,	**Deshmi 5- OE duhet te ofrojë listën e pajisjeve te kërkuara për ekzekutimit të punëve e vulosur dhe nënshkruar, për automjetet që kanë regjistrim të dëshmohet me librez valide dhe foto, ndërsa për pajisjet tjera te dëshmohet me foto dhe deklaratë mbi posedimin e tyre apo marrëveshje mbi marrjen me qera për projektin në fjalë**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratë Publike
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova i Javne Uprave
Ministry of Internal Affairs and Public Administration

Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë /
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Ndërtimi i Stacionit Policor Veri Prishtinë-Rivleresim

Nr. i Prokurimit:	**214-22-10936-5-1-1**
Nr i brendshëm	**214/22/176/511**

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave[2]
1.	" MABCO CONSTRUCTIONS " SH.P.K., Azizs Abrashi 140, 10000, Zona Industriale - Prishinet, Kosovë	2,179,743.82 €
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik LIMITPROJECT SH.P.K.; DELTA - CCD SH.P.K.; Rinesa SH.P.K., Prishtine,Hyzri Talla, Qendra Tregtare, p.n, 10000, Prishtine, Kosovë.	1,647.348.74 €
3.	Astraplan SH.P.K., K.E DIELLIT RR. M.GRADICA H.5/6, 10000, PRISHTINË, Kosovë.	1,388,888.89 €
4.	Pro & Co Group SH.P.K., Rr.Marigona Residenc Llapllasellë p.n, 10500, Graqanicë, Kosovë.	1,436,569.47 €
5.	Çeta -General Invest Group, TRUBUHOC, 31000, ISTOG, Kosovë.	1,427,427.00 €
6.	Grup i Operatorëve Ekonomik: " HIDRO PROJECT " SH.P.K.; „ ENGRUP " SH.P.K., Bill Klinton,14-1, -, PRISHTINË, Kosovë.	1,188,259.11 €
7.	NPN EUROING SH.P.K., XËRXË, 21000, RAHOVEC, Kosovë.	1,367,396.72 €
8.	Olti Trasing SH.P.K., Bill Klinton, 10000, PRISHTINE, Kosovë.	1,448.000.00 €
9.	"AL-BER" SH.P.K., Pecan, Suhareke, 23000, Suhareke, Kosovë	1,224,268.14 €

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Policia e Kosovës shpërblen me kontratë OE Pro & Co Group SH.P.K. Kosovë në vlerë totale 1,436,569.47 €

Data: 15/09/2023.

Emri dhe mbiemri i ZPP: Artan Fejza

[1] Ketij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde te njoftimeve: B42, B45 dhe B46.(shtoni letra njoftuese sipas nevojes).
[2] Në rast të procedurave të kufizuara/procedurave konkurruese me negociata t'i bashkangjiten letrat standarde të njoftimeve: B43 dhe B44.(shto letra standarde sipas nevojës), derisa kolona "Vlera totale e ofertave" nuk plotsohet me te dhena.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi PSH. Nr. 356-373-389/2023 i dt:01.08.2023.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Astraplan SH.P.K.**

Autoriteti Kontraktues-Policia e Kosovës, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës punë. Vlera e parashikuar e kontratës 1,538,842.70 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët.**

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, ndërsa Ekspertja shqyrtues ka nxjerr raport të ekspertizës me Nr.373/0204 të datës 22.06.2023. Po ashtu, Paneli Shqyrtues ka gjykuar me Vendimin PSH.nr.356,373,389/2023 të datës 01.08.2023, duke e aprovuar si të bazuar ankesën e OE "Astraplan" SH.P.K., kurse ka anuluar njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimi dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, kundrejt pretendimeve ankimore të OE ankues "Astraplan" SH.P.K., sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 59, 60, 69 dhe 105 të LPP-së, si dhe nenin 40 paragrafin 40.3 të Rruopp dhe nenin 9.1&9.2 të Dosjes së tenderit "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe /ose profesionale".

Lidhur me mjetin e kontestuar **eksperti teknik** jep përgjigjeje si në vijim: **Eksperti teknik** konsideron se në bazë të dokumenteve të ofruara në dosjen e tenderit sa i përket kërkesës ***"Një autovinç (kamion për bartje te materialeve ndertimore min 7ton".*** Në përshkrimin e kërkesës AK e ka lënë të paqartë kërkesën pasi që makineria Autovinç dhe kamion për bartje të materialeve ndërtimore dallojnë si makineri.

OE ankues ka dhëne sqarimet ne piken ankimore. Sipas sqarimeve te dhëna ne ankesën e OE dhe dokumenteve te ofruara ne dosjen e tenderit (shih foto me poshtë) janë dhënë edhe rekomandimet. Eksperti teknik gjatë vlerësimit ka verifikuar të gjitha dëshmitë dhe sipas këtyre dokumenteve dhe dëshmive OE ankues ka plotësuar kërkesën edhe për **autovinç** edhe **kamion për bartje**, cila do qoftë kërkesa e AK (pasi që kërkesën e AK konsideroj që ka dykuptimësi) eksperti teknik jep sqarimin se kërkesa e autoritetit kontraktues konsiderohet e plotësuar nga OE ankues "Astraplan".Andaj bazuar në dëshmitë si më poshtë eksperti teknik konsideron se pretendimi lidhur me makineri është i bazuar.

Shih dëshmitë si në vijim për kërkesën: "Një autovinç (kamion për bartje te materialeve ndërtimore min. 7ton".

MARRËVESHJE PËR MARRJEN ME QERA TE PAJISJEVE DHE MJETEVE.

Për ko-operim në pjesmarrje të përbashkët për realizime të projekteve në infrastructure, ndërtime,riparime gjithashtu pjesmarrje për zhvillimin e projekteve Profesionale hulumtuese e shkencore, asistencës teknike në përpilimin e projekteve Profesionale, simpoziumeve, dhe shërbimeve të tjera reciproke nga fushë veprimtaria e ndërtimit të lartë, etj.

Për projektin:
NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË
Numri i prokurimit: 214-22-10936-5-1-1
Nr i brendshëm: 214-22-176-511
Të dates 28.11.2022.

Marrëveshja është bërë në **Prishtinë** me _03.*11.2022*_ në mes:

''ASTRAPLAN'' SH.P.K.-Prishtinë me nr. Unik 810537920 qiramarrës

N.T.P ''UNIVËRSAL''(Isa Morina B.I) -Pejë me nr. Biznesi 80020473, dhe nr unik 810398067, qiradhënës

Kjo marrëveshja është me validitet të kohëzgjatjes së kësaj kontrate deri në përfundimin e saje (deri në pranim teknik)

Partnerët kanë vendosur të bashkëpunojnë për të gjitha punimet që kanë të bëjnë me punët ndertimore, punët tokësore germimet, mbushjet, punet metalike, punet e betonit Etj.

Partnerët pajtohen që ''**Astraplan**'' **Sh.P.K** do të ketë në dispozicion të gjitha makineritë që është e nevojshme për përfundimin e kontratave sipas kushteve të kontratës dhe projektit po ashtu dhe siq kërkohët nga investitori

Drejtori
Florim Istrefi

''Astraplan'' Sh.p.k

Drejtori
Isa Morina

N.T.P ''Univërsal

MARRËVESHJE PËR MARRJEN ME QERA TE PAJISJEVE DHE MJETEVE.

Për ko-operim në pjesmarrje të përbashkët për realizime të projekteve në infrastructure, ndërtime,riparime gjithashtu pjesmarrje për zhvillimin e projekteve Profesionale hulumtuese e shkencore, asistencës teknike në përpilimin e projekteve Profesionale, simpoziumeve, dhe shërbimeve të tjera reciproke nga fushë veprimtaria e ndërtimit të lartë, etj.

Për projektin:
NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË
Numri i prokurimit: 214-22-10936-5-1-1
Nr i brendshëm: 214-22-176-511
Të dates 28.11.2022.

Marrëveshja është bërë në **Prishtinë** me *_03.11.2022_* në mes:

''ASTRAPLAN'' SH.P.K.-Prishtinë me nr. Unik 810537920 qiramarrës

''UNICRON'' SH.P.K -Pejë me nr nr.Unik 810747090, qiradhënës

Kjo marrëveshja është me validitet të kohëzgjatjes së kësaj kontrate deri në përfundimin e saje (deri në pranim teknik)

Partnerët kanë vendosur të bashkëpunojnë për të gjitha punimet që kanë të bëjnë me punët ndertimore, punët tokësore germimet, mbushjet, punet metalike, punet e betonit Etj.

Partnerët pajtohen që ''**Astraplan**'' **Sh.P.K** do të ketë në dispozicion të gjitha makineritë që është e nevojshme për përfundimin e kontratave sipas kushteve të kontratës dhe projektit po ashtu dhe siq kërkohët nga investitori

Drejtori
Florim Istrefi

''Astraplan'' Sh.p.k

Drejtori
Isa Morina

''Unicron'' Sh.p.k

RKS
03-827-01
CRA/YPB/VRC 1478077
CRA/YPB/VRC 1478077
CRA/YPB/VRC 1478077

03-827-01
16-12-2019
N.P.T "Universal"
Fatmaj PEJË PEJË
04-01-1999
IVECO
A1ED0030
1999
Diesel
E Bardhë
Kamion Kran 2 Dyer

IVECO
VOLVO



REPUBLIKA E KOSOVËS
РЕПУБЛИКА КОСОВО
REPUBLIC OF KOSOVO

RKS

CERTIFIKATA E REGISTRIMIT TË AUTOMJETIT
УВЕРЕЊЕ РЕГИСТРАЦИЈЕ ВОЗИЛА
VEHICLE REGISTRATION CERTIFICATE

03-524-DE

CRA/YPB/VRC 1923154 CRA/YPB/VRC 1923154 CRA/YPB/VRC 1923154

A	Numri i regjistrimit; Број регистрација; Registration number;	03-524-DE
I	Data e regjistrimit; Датум регистрација; Date of registration;	08.11.2022
C	Të dhënat personale; Лични подаци; Personal data;	
C.2	Pronari i mjetit; Власник возила; Owner of the vehicle;	
[redacted]	Mbiemri ose emri i biznesit; Презиме или назив на правно лице; Surname or business name;	Isa Morina B.I.
C.2.2	Emri; Име; Name;	
C.2.3	Adresa; Адреса; Address;	1. Ferizaj Pejë
B	Data e regjistrimit të parë; Датум прва регистрација; Date of first registration;	15.04.1999
D	Automjeti; Возило; Vehicle;	
D.1	Prodhuesi; Произвођач; Make;	Volvo
D.2	Tipi; Тип; Type;	FM12 42 R
D3	Përshkrimi komercial; Комерцијални опис; Commercial description;	
E	Numri identifikues i automjetit; Идентификациони број возила; Vehicle identification number;	YV2J4DAA1XA294767
S	Viti i prodhimit; Година производње; Year of production;	1999
S	Kapaciteti i ulëses; Капацитет седишта за седење; Seating capacity;	2
S.1	Numri i vendeve; Број места за седење; Number of seats;	
S.2	Numri i vendeve për ngrënës; Број места за стојење; Number of standing places;	
Q	Raporti Fuqi/Pesh [ne kW/kg]; Однос Снага/тежина [у kW/kg]; Power/Weight ratio [in kW/kg];	
F	Pesha; Маса; Mass;	18000
F1	Pesha maksimale e masës së lejuar; Највећа дозвољена маса; Maximum permissible mass;	7200
G	Pesha e automjetit; Маса возила; Mass of the vehicle;	10800
K	Homologimi; Хомологација; Type of approval;	
P	Motori; Мотор; Engine;	
P1	Kapaciteti [ne cm3]; Запремина [у cm3]; Capacity [in cm3];	12130
P2	Fuqia maksimale neto [ne kW]; Максимална нето снага [у kW]; Maximum net power [in kW];	309.00
P3	Lloji i karburantit ose burimi i energjisë; Врста горива или енергија; Type of fuel or power source;	Dizel - EURO 3
R	Ngjyra e automjetit; Боја возила; Color of the vehicle;	E VERDHË/ E HIRIT
2A	Shënime; Напомене; Remarks;	HOKE-TERHEQESE ME KRAN me 2 dyer
		N.P.T." Universal "

14.09.2021
13.09.2022
RKS
03-436-XB
CRA/YPB/VRC 1542907
CRA/YPB/VRC 1542907
CRA/YPB/VRC 1542907


14.09.2020
Van Hool
S 336/27
N.P.T." Universal " Ibarra Tallnore
12.06.2015

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO
RKS
CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT TË AUTOMJETIT
VERIFIKIMI I REGISTRIMIT
VEHICLE REGISTRATION CERTIFICATE
03-390-DI
CRA/YPB/VRC 1536733
CRA/YPB/VRC 1536733
CRA/YPB/VRC 1536733

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Astraplan SH.P.K."- Prishtinë, kundrejt ofertës së OE të rekomanduar për kontratë "Pro & Co Group SH.P.K.", ku OE ankues pretendon se nga qasja në dokumentet e OE të rekomanduar nuk na janë prezantuar dokumentet si:

b) Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.

c) Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike - Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë" së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës

d) Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se kërkesat e tilla bëjnë pjesë tek Kërkesat e përshtatshmërisë dhe se dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen nga ofertuesi fitues, përpara publikimit

të dhënies së kontratës. **Dështimi** për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, që do të thotë se ofertuesi do të refuzohet, do të humbasë garancinë e sigurisë së ofertës dhe Autoriteti Kontraktues do të vazhdojë me tenderuesin e listuar në vendin e dytë. Thuhet tek Kërkesat e përshtatshmërisë dhe Dëshmia e kërkuar dokumentare. **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se bazuar në platformën e prokurimit, ka hasur në kërkesën e AK të datës 14.09.2023, drejtuar OE të rekomanduar për kontratë "Pro & Co Group SH.P.K."- Prishtinë, lidhur me sjelljen e dokumenteve sipas dosjes së tenderit nenin 6.4. të DT. Po ashtu bazuar në platformën e prokurimit kemi hasur në dështmitë e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontrata lidhur me ketë kërkesë. Andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Provë: Dështmi shkëputur nga platforma e prokurimit



Lidhur me pretendimin e OE ankues "Astraplan SH.P.K."- Prishtinë, se OE i rekomanduar për kontratë "Pro & Co Group SH.P.K."- Prishtinë nuk plotëson kriteret mbi aftësitë teknike profesionale, përkatësisht nuk plotëson kushtin prej 1,000,000.00 euro, se ka përfunduar me suksese punë të natyrës së njëjtë apo ngjashme, ku i njëjti është i pa përgjegjshëm pretendon ankuesi. Më tej, OE ankues në ankesë potencon se në bazë të listës së kontratave të paraqitura

nga OE i rekomanduar, kontrata të cilat duhet ti merren parasysh vlerat e tyre është **629,094.53 euro**, ndërsa kontratat me numër rendor 14 dhe 15 nuk duhet të merren parasysh për këto arsye potencon ankuesi:

Kontrata me numër rendor 14. Me vlerë 459,990.26 euro, data e nënshkrimit me 27.04.2020 nga grupi i OE Pro & Co Group shpk & ARCHI TIME SHPK dhe N.N.T. "A.B.C." me kohëzgjatje prej 36 muajsh, dmth ne kohen kur është dorëzuar oferta qe është ne proces te ankesës,

1.Kjo kontrate ka qen e pa përfunduar dhe nuk munde te merret për baze ne këtë vlerësim.

2.Titulli I kontratës është Mirëmbajtja e objekteve te administratës komunale ne Prizren

3.Mungon Referenca, edhe pse ka një reference me tjetër titull qe po përputhet numri brendshëm i prokurimit, kjo është ne kundërshtim me kërkesën e DT-s dhe NJK

Kontrata me numër rendor 15. Me vlerë 322,281.50 euro, Kontrata është nënshkruar me 03.08.2022 me kohëzgjatje prej 36 muajsh, dmth ne kohen kur është dorëzuar oferta qe është ne

proces te ankesës, kjo kontrate ka qenë e pa përfunduar dhe nuk munde te merret për baze ne këtë vlerësim.

Referenca e paraqitur për këtë kontrate është e pa vlefshme sepse, ne ketë reference edhe AK-ja e ka shënuar qe punimet janë e kryer pjesërisht, e qe është në kundërshtim me kërkesën e DT-s dhe NJK

Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK në dosje të tenderit ka kërkuar:

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: **Kerkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 1,000,000.00 €**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Deshmi 1-Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të nënshkruar dhe realizuara të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate), të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, të dëshmuara me referenca ose raporte përfundimtare të pranimit teknik në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatëse, për punët e realizuara dhe pranuar , te cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, natyrën e punës dhe vendin e realizimit të punëve. • Kur ndërtimi i është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër (jashtë RKS), për dëshmi duhet te dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera) te lëshuara nga autoriteti i tillë. • Kur ndërtimi është bere për një blerës privat, duhet te dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e punëve ose raportet e pranimeve teknike përfundimtar**

Lidhur me këtë kërkesë, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se AK në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratat ka kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për natyrës së njëjtë apo të ngjashme jo më pak se 1,000,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, të cilat duhet të **dëshmohen me referenca ose raporte përfundimtare të pranimit teknik në kopje të nënshkruara dhe vulosur nga autoritetit përkatës për punët e realizuara dhe pranuara, të cilat duhet te tregojnë numrin e prokurimit ose kontratës vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës natyrën e punës dhe vendin e realizimit të punëve** … Lidhur me këtë kërkesë, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se bazuar në shkresat e lëndës në e-prokurim, përkatësisht në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, i njëjti ka bashkangjitur me ofertë dokumentet me titull *"04. Lista e projekteve dhe referencat-Ndërtimi i Larte_PCG.pdf"* dhe *"04.1 Lista e projekteve dhe pranimet teknike me referenca Pro Co Group.pdf"*, ku në këto dy dokumente ka kontrata dhe referenca për punë të kryera. Sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me kontratën me numër rendor 14 tek lista "04. Lista e projekteve dhe referencat-Ndërtimi i Larte_PCG.pdf", **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se kontrata me titull "Renovimi i objekteve të Administratës Komunale Prizren" e nënshkruar me datë 27.04.2020 dhe përfunduar me datë 02.12.2021 në vlerë prej 459,990.26 euro, e lidhur

me AK Komuna e Prizrenit, ku për këtë kontratë, OE i rekomanduar e ka përfshirë këtë kontratë në listën e kontratave për punë të përfunduara dhe ka prezantuar referencën nga Komuna e Prizrenit për këtë kontratë. Referenca në emër të kësaj kontratë mban titullin *"Renovimi i objekteve të Administratës Komunale Prizren"* me numër të prokurimit: 622-19-217-211, ndërsa OE ankues pretendon në ankesë se titulli është ***Mirëmbajtja e objekteve te administratës komunale ne Prizren, dhe se mungon referenca, edhe pse ka një reference me tjetër titull qe po përputhet numri brendshëm i prokurimit, kjo është në kundërshtim me kërkesën e DT-s dhe NJK.***

Ekspertja shqyrtuese pas hulumtimit dhe kërkimit në platformën e e-prokurimit të kësaj reference, duke hulumtuar me numrin e prokurimit 622-19-217-211, kemi hasur në njoftimin për kontratë të publikuar me datë 03.12.2019, me titull të aktivitetit të prokurimit "Mirëmbajtja e objekteve të Administratës Komunale në Prizren", numër të brendshëm të prokurimit 622-19-217-211 dhe me numër të prokurimit 622-19-9123-2-1-1, dhe kontraten. Pra, në bazë të këtij njoftimi për kontratë të publikuar nga KK Prizren, dhe kontrates rezulton se titulli i kontratës në referencën e dorëzuar nga OE i rekomanduar nuk është i njëjtë me titullin sikurse në njoftimin për kontratë dhe kontraten e publikuar. Andaj, autoriteti kontraktues gjatë rivlerësimit konform nenit 72 të LPP-së, duhet ta sqaroj ketë pretendim të OE ankues për këtë referencë, duke kërkuar nga AK Komuna e Prizrenit që të sqaroj këtë kontratë, e cila kontestohet nga ankuesi.

Provë: Shkëputur nga sistemi e-prokurimit me numër të brendshëm të prokurimit 622-19-217-211 dhe me numër të prokurimit 622-19-9123-2-1-1.

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PJESA B: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË [1], KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

Komuna e Prizrenit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

"Pro & Co Group" SHPK Kllokot & "Archi Time" SHPK Prizren & NNT "ABC" Podujevë (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

Titulli i kontratës: **Mirmbajtja e objekteve të Administratës Komunale në Prizren**

me numër identifikues: **Numrin e Prokurimit : 622 – 19 –9123– 211.**

Nr prokurimit i brendshëm 622 – 19 –217– 211.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i sherbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performophen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë Autoritetin Kontraktues të blejë ndonjëren prej tyre. Autoriteti Kontraktues me të drejtë të tij mund të blejë më pak ose më shumë sasi se sa ato sasi të vlerësuara për artikull p.sh brenda një pjese (loti) të njëjtë. Megjithatë, Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Ofertuesi i Shërbimeve NUK do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do ti lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktues vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parapara të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktues vendos të MOS blejë ASNJË nga këto sasira për disa artikuj.

1.5 Kontrata hyne në fuqi me **27. 04. 2020 dhe përfundon në datën 26. 04. 2023**

Neni 2 Koha e përfundimit

Provë: Shkëputur nga Oferta e OE të rekomanduar, kontrata me numër rendor 14 dhe referenca.

Deshmi lista e projekteve e shkeputur dhe referenca:

14	Renovimi i objekteve te Administrates Komunale Prizren	27.04.2020	02.12.2021	459,990.26	Komuna e Prizrenit	Isa.osmankaj@rks-gov.net	038200447 04
15	Renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve të Komunës së Prizrenit	03.08.2022	10/11/2022	322,281.50	Komuna e Prizrenit	Isa.osmankaj@rks-gov.net	038200447 04

(Shto/fshij sipas nevojës)

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Vula _____

Republika e Kosovës
Repulika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria e Administratës
Më 03/12/2021

REFERENCË:	
Për/Za/To:	" Pro & Co Croup" dhe " Archi Time" SHPK Prizren
CC:	
Nga/Od/From:	Drejtoria e Administratës- Drejtori Osman Hajdari
Tema/Subjekat/Subject:	*Referencë për punët e kryera në projektin -**"Renovimi i objekteve te Administrates Komunale Prizren"***

Në bazë të kërkesës nr 02-370-189532 te datës 02.12.2021 te OE " **Pro & Co Croup" dhe " Archi Time shpk Prizren**, për lëshimin e një dokumenti-dëshmije për punët e kryera në realizimin e projektit; Drejtoria e Administratës e shqyrtoj këtë kërkesë dhe duke u bazuar në projektin e realizuar lëshon këtë:

R E F E R E N C Ë

Në kuadër të realizimit të projektit dhe me nënshkrimin e Kontratës, nr 622-19-217-211, ne realizimin të projektit- ***"Renovimi i objekteve te Administrates Komunale Prizren"*** ne vlere prej **459.990.26 €**

OE në fjalë punët në hartimin e projektit- i ka kryer me kohe dhe gjithnjë duke ju përmbajte obligimeve të parapara në kontratë.

Drejtori
Osman Hajdari

Po ashtu, sa i përket pikës së pretendimit ankimor se kontrata kornizë prej 36 muajve duhet të

përfundon pas 36 muajve, **ekspertja shqyrtues sqaron** se kontrata kornizë mund të përfundojnë në aspektin kohor të përfundimit të punëve dhe në aspektin sasior kur përfundon sasia. Për me shumë referoju nenit 56.10 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik.

56.10 Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo qe Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 126 specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), ***pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.*** *Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe ne rast të arritjes se pragut të lejuar AK nuk mund te bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.*

Sa i përket pretendimi tjetër ankimore lidhur me kontratën nr. **me numër rendor 15** me vlerë 322,281.50 euro**,** ku ankuesi potencon se kontrata është nënshkruar me 03.08.2022 me kohëzgjatje prej 36 muajsh, d.m.th. në kohën kur është dorëzuar oferta, që është në proces të ankesës, kjo kontratë ka qenë e pa përfunduar dhe nuk mund të merret për bazë në këtë vlerësim. Gjithashtu, referenca e paraqitur për këtë kontratë është e pa vlefshme sepse në këtë reference edhe AK-ja e ka shënuar që punimet janë kryer pjesërisht, e që është në kundërshtim me kërkesën e DT-s dhe NJK.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se duke marrë për bazë kërkesën e autoritetit kontraktues, përkatësisht kërkesat tek kapacitetit teknik dhe profesional Kërkesa "*1 Operatori ekonomik duhet* ***të ofrojë dëshmise <u>ka përfunduar</u> me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit*** *(nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 1,000,000.00 €",* dhe referencën e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontrata nga komuna e Prizrenit e datës 10.11.2022, ku ceket se ***"OE në fjalë ju kanë pranuar punimet e kryera <u>pjesërisht</u> ne bazë të kontratës ne vlerë prej 322,281.50 euro"*****,** si duke pasur parasysh rolin dhe funksionet e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik, institucion i cili është rregullator i prokurimit, ku tek interpretimi Nr.10.22.11.2022 është dhënë sqarimi se kontratat

duhet të jenë të realizuara - përfunduara (jo në realizim e sipër), andaj pretendimin ankimor e kualifikojmë si të bazuar. Për më tepër, referoju interpretimit të KRPP-së si më poshtë:

10. 22.11.2022 Kurdo që kërkohet në FDT të Dosjes së Tenderit dhe në Njoftim për Kontratë "Lista e kontratave të realizuara (përfunduara) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë", gjatë vlerësimit të tenderëve, a duhet të merret për bazë totali i vlerës së kontratës apo duhet të përpjesëtohet?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim: Sa i përket dëshmive të kërkuara nga Autoritetet kontraktuese në FTD të Dosjes së tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në lidhje me Aftësitë teknike dhe/ose profesionale, paragrafi 4.2 i nenit 69 të këtij ligji përcakton: 4.2 listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira,shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja ecertifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënënshkrura nga autoriteti i tillë publik: (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë; Në kuptim të nën-paragrafit 4.2 të nenit 69 të lart cituar, AK në rast se kërkon dëshminë - Listën e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, (nga data e njoftimit për kontratë) kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë. Pra për bazë duhet të merret periudha e përfundimit jo e fillimit të kontratës. Për më shumë, kjo do të thotë se në këtë listë duhet të saktësohen të gjitha informatat e hijezuara në këtë nën-paragraf: Llojin e shërbimeve, shumën e kontratës që nënkupton totalin e përgjithshëm të kontratës, datën dhe pranuesin. Si rrjedhojë, gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve në përputhje me dispozitën e lart cituar duhet të merret për bazë shuma totale e kontratës së specifikuar në listë dhe jo të përpjesëtohet. Shembull: Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën 3.000.000 euro kontrata kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Dëshmia dokumentare 1: Lista e kontratave kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Në rast se kërkesa e kontratave të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë i referohet së bashku një totali prej 3,000,000 euro në tri vitet e fundit dhe operatori ekonomik ka realizuar (përfunduar) një kontratë tri vjeçare t në vlerë prej 3,000,000 euro (kontrata e cila ka filluar dy vite më herët), konsiderohet se OE ka përmbushur kërkesën minimale vetëm me atë kontratë. Kushti minimal është përmbushur duke prezantuar dëshminë Listën e kontratave të realizuara së bashku në total prej 3,000,000 euro në tri vite dhe nuk ka rëndësi se kontrata ka filluar dy vite më herët.

Lidhur me pretendim e OE ankues se lista e kontratave, duhet të merren parasysh vetëm nga data 13.10.2022 deri me 13.10.2019 dhe kontrata e OE të rekomanduar që plotësojnë kushtin arrijnë vlerën 629,094.53 euro. **Ekspertja shqyrtuese** siç e sqaroj dhe më lart, OE i rekomanduar në ofertën e tij ka bashkangjitur dy lista të kontratave, listën me titull të dokumentit "04. Lista e projekteve dhe referencat-Ndërtimi i Larte_PCG.pdf" dhe listën me titull të dokumentit "04.1 Lista e projekteve dhe pranimet teknike me referenca Pro Co Group.pdf", ku në mesin e këtyre dy listave, ka kontrata të cilat janë të përfunduara brenda periudhës së kërkuar sipas kërkesës së vendosur në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë,

Andaj, AK gjatë rivlerësimit duhet ti shqyrtoj këto dy lista të kontratave dhe të sigurohet nëse mbulohet kërkesa e vendosur nga vet AK për kontrata të përfunduara në vlerë prej së paku 1 milion euro.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se drejtori i zyrës së prokurimit Artan Fejza ka vepruar ne kundërshtim me vendimin e OSHP-s nr.373/23, ku të njëjtit do duhet ti revokohet certifikata e prokurimit konform nenit 25 par 8 , tutje OE ankues potencon se arsyetimi i të njëjtit është për keqardhje, kamuflimi dhe manipulimi me dëshmi e tenderit dhe dokumentet e tenderit për përfitime personale dhe inate personale me kompaninë e tyre është vepër penale, duke keqpërdor 47,680.59 euro të buxhetit të Republikës se Kosovës dhe se i njëjtit ka vonuar Policin e Kosovës për realizimin e këtij projekti për me shumë se 270 dite pasi që për 30 dite max do duhet te kryhet vlerësimi qe nga dita e dorëzimit të tenderit kanë kaluar me shumë se 9 muaj. **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se pretendimet se personi e apostrofuar se ka inate me kompaninë e tij dhe këtë e ka bere për përfitime personale të njëjti ti revokohet certifikata etj. **Ekspertja shqyrtuese** konsideron se ky pretendim ankimor nuk ka të bëjë me çështje në të cilën mund të japim përgjigje sepse i gjithë vlerësimi jonë duhet të bazohet në shkresa/prova dhe argumente për secilën përgjigje që japim por nëse OE ankues ka argumente apo konsideron se mund ti dëshmon këto pretendime mundë ti drejtohet organeve tjera kompetente. Po ashtu është në kompetencë të OSHP-së, Panelit shqyrtues të ndërmerr masa ligjore ndaj autoriteteve kontraktues apo ndonjë veprimi tjetër lidhur me personat përgjegjës. Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se AK ka vonuar ketë aktivitet të prokurimit me shumë se 9 muaj, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se pretendimi i OE ankues lidhur me tej zgjatjen e afateve të vlerësimit të ofertave **është i bazuar** për faktin se edhe në raste kur natyra e aktivitetit të prokurimit është shumë komplekse, AK duhet që brenda 50 dite (1 muaj e 20 ditë) të përfundoj ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas nenit 40.3 të RREGULLORES Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK. Pra kjo dispozitë ligjore e ka kufizuar vlerësimin e ofertave dhe nuk mund të zgjatet më shumë afati për vlerësim se 1 muaj e 20 ditë. Dhe ky pretendimi propozoj të trajtohet si gjykuar sipas nenit 16, par. 3 të Rregullores nr. 01/2020 të Organit Shqyrtues në kuptim të nenit 105 nënparagrafit 2.16 të LPP-së, me vendim PSH.NR.356,373 dhe 389/2023 të datës 01.08.2023.

Prandaj bazuar ne atë qe u përshkrua si me larte ankesa e operatorit ekomomik ankues është e bazuar ndërsa propozimi i ekspertit shqyrtues/teknik për AK- Policia e Kosovës, është qe

lenden ta kthej në ri vlerësim me qellim qe të aplikohen në tërësi dispozitat e LPP-se ne fuqi , konkretisht nenit 59 dhe 72 i LPP-se dhe të pasqyrohet gjendja reale e ofertave në raport me kërkesa e vendosura nga vet AK.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Astraplan SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Majlinda Bedrolli

Enver Bytyçi